



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

***Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri,
Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion***

Mbledhja e dt. 24.08.2007

Salla: N-225 ora 9.00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.

Procesverbal

Morën pjesë: Ibush Jonuzi - kryetar, Bajrush Xhemali, Mahir Yagcillar, Ilmi Ahmeti, Zef Morina, Sale Berisha, Milazim Haliti, Brikena Kryeziu, Vezira Emrush Xhevdet Neziraj ndërsa munguan: Sllagjan Iliq, Hatixhe Hoxha, Ylber Hysa, Fadil Gashi

Të ftuar si dhe prezent ishin edhe: Përfaqësuesit e ZRRE-së, Naim Bejtullahu, Theranda Beqiri, Nysret Avdiu.

Mbledhjen e drejtoi Ibush Jonuzi – kryetar i Komisionit, me këtë

Rend dite

1. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë
2. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua.

1. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Ibush Jonuzi- përshendet anëtarët e bordit të Rregullatorit të energjisë të cilët janë hartues të këtij raporti. Sipas ligjit të Rregullatorit të energjisë duke u bazuar në neni 10 ZRRE-ja është e obliguar si organ që për çdo vit të përgatit raport Kuvendit të Kosovës.

Me qe këtë vit kanë kaluar kompetencat nga ndërkombëtarët në vendor, tani bordi është kompletuar nga vendoret, pak me vonës ka arritur raporti i punës për shkak të mungesës së nevojshme të anëtarëve të bordit të ZRRE-së. Kërkoj që të plotësohet

Bordi me një anëtar të bordit si dhe stafi i Zyrës së Rregullatorit.

Në raport është përfshirë edhe puna e 3 mujorshit të parë të këtij viti. Shihet se është një raport mjaftë përmbajtjesor, profesional dhe gjithë përfshirës. Ne jemi komision funksional duhet ta shqyrtojmë dhe rekomandojmë për seancën plenare në procedim të mëtejshëm.

Naim Bejtullahu- duke u ndërlidhur me diskutimin e kryetarit të komisionit lidhur me vonesën e raportit, tha se jemi në situatë të pavolitshme lidhur me kapacitetet zyrës së Rregullatorit të energjisë për shkak të zvogëlimit të stafit nga 25 anëtar në 15 anëtar, ku janë larguar kryesisht ekspertët.

Ai njoftoi se pjesa me sfida të Zyrës së Rregullatorit ka qenë periudha e implementimit, dhe tha se kemi hy në reformën e tarifave por nuk mjaftojnë vetëm këto. Në sektorin e energjisë tha se s'ka ndryshime rapide. Kapaciteti prodhues dhe ai furnizues pothuajse është i njëjtë. Importi pothuajse është 4 herë më i shtrenjët dhe veshirë për tu siguruar për shkak të gjendjes jo të mirë edhe në rajon.

Në raport janë të përfshira edhe implikimet të cilat Zyra i ka kaluar për periudhën 3 vjeçare duke e përgatitur edhe kornizën rregullative të sektorit të energjisë e cila është bazë për rregullimin e ekonomisë së këtij sektori.

Bajrush Xhemajli, nënkryetar i komisionit tha se Rregullatori i Energjisë duhet të jetë me i pavarur sepse është me i rëndësishëm dhe nësi komision dhe Parlament të kemi qasje të drejtë për ato tendenca për me ndryshu ligjin për Rregullatorin, por tha se i kemi ndërpre ato tendenca.

Ilmi Ahmeti anëtarë i komisionit bëri pyetje Zyrës së Rregullatorit për dallimin në çmimin importues dhe atë eksportues.

Naim Bejtullahu, tha se na blejmë energji ditën dhe se ajo kushton edhe garantimi kushton, ndërsa tha se në energji shesim natën dhe me qënës energjia natën është me e pa nevojshme ajo kushton me lire. Dhe shtoi se 50% e konsumatorëve e vjedhin rrymën në Kosovë.

Zef Morina, anëtar i komisionit tha se gjendja në përgjithësi në Kosovë s'është e mirë, por ato kapacitete tha që i kemi duhet ti shfrytëzojmë nësi duhet, arsyeja pse s'kemi rrymë nuk është vetëm te mos pagesa, por edhe humbjet në transimion dhe presioni për mos ndërtimin e termocentrelit të ri. Dhe tha se në nuk jemi të barabart në këtë aspekt me vendet e rajonit si me Maqedonin e Malin e Zi.

Naim Bejtullahu tha se mungesa e kapaciteteve e ka ndikimin e vet edhe në çmim. Gjithashtu ai prezantoi edhe situatën në rajon ku tha se Shqipëria i mungon 1/3 e kapacitetit energjetik, ndërsa Mali i Zi importon aq sa Kosova. Dhe shtoi se ka perpjekje që transimioni i Kosovës të njihet ndërkombëtarisht për brenda 2-3 vitesh dhe të jetë i barabart me vendet e tjera ku do të jetë në pozitë shumë më të volitshme. Por ai tha se gjendja në përgjithësi e rajonit me energji është në pozitë të palakmueshme ku vetëm Bullgaria e Rumania ka kapacitete shtesë.

.Milazim Haliti , bëri vërejtje duke thënë se jemi në fund të gushtit e në fillim të shtatorit e ne po e shqyrtojmë ende raportin e vitit 2006.
Në vazhdim komisioni pasi që e shqyrtoi , e miratoi raportin e ZRRE-së, dhe nxorri këtë:

Rekomandim

Bazuar në kreun 9.1, të Kornizës Kushtuese dhe të rregullës 41.2;3 të Rregullore së Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, i rekomandon Kryesisë së Kuvendit , miratimin e Raportit vjetor për vitin 2006, të Zyrës së Rregullatorit për Energji, të cilin komisioni e miratoi në mbledhjen e mbajtur më dt. 24.08.2007.

Raporti nga komisioni funksional është vlersuar si shumë profesional dhe gjithëpërfshirës.

Ky Raport është miratuar me vonesë nga ana e Komisionit për shkak të mungesës së numrit të nevojshem të anëtarëve të Bordit të ZRRE-së, për hartimin e Raportit në fjalë.

Andaj kërkojmë që sa ma shpejtë që të jetë e mundur Kuvendi i Kosovës të propozoi dhe të emërojë një anëtarë tjetër të bordit , të ZRRE-së , duke vepruar sipas shkresës së z.Paul Acda nr. 02-3631 të dt. 06.08.2007.

Të ndryshme

Ne fund **Ibush Jonuzi** njoftoi antarët e komisionit lidhur me projekt rezoluten per Trepçën qe do te paraqitet me dt. 27.08.07 Kuvendit për miratim, ku nga antarët e Komisionit morri pelqimin e plote per mbeshtetje.

2.Shkresa e UNMIK-ut për Ligjin e sigurisë së komunikacionit rrugor
Mahir Yacillar-duhet të kerkohet teksti ispastruar nga zyra ligjore e UNMIK-ut.
Brikena Kryeziu- është mirë që të bëhet edhe harmonizimi me Komisionin Parlamentar të buxhetit.

Mbledhja përfundoi në ora 13.00

Kryetar I Komisionit

Ibush Jonuzi

